



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije/Ministry of Economy**

---

## **NJOFTIM PËR KONTRATË**

**Procesi i ofertimit konkurrues/Nr. i brendshëm protokollar: 01 – 001 - 2023**

**1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues:**

Ministria e Ekonomisë, Republika e Kosovës

Adresa: Sheshi “Zahir Pajaziti”, Nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

**2. Emri dhe detajet e personit kontaktues:**

Z. Selami Berisha, Zyrtar për prokurim, Ministria e Ekonomisë

Email-i: [selami.berisha@rks-gov.net](mailto:selami.berisha@rks-gov.net)

Telefoni: +3833820021532

**3. Titulli i kontratës që i atribuohet Autoritetit Kontraktues:**

Procesi Konkurrues për Dhënie e Çmimit të Garantuar të Blerjes për Energjinë e Prodhuar nga një Central Solar Fotovoltaik (FV) prej 100 MW i cili do të Ndërtohet në Pronë Publike.

**4. Forma, objekti dhe lloji i kontratës:**

Dhënia e një çmimi të garantuar të blerjes për energjinë e prodhuar nga një central solar FV me kapacitet të instaluar prej së paku 90 MW dhe më së shumti 105 MW rrymë alternative (AC). Kjo do të shpie në nënshkrimin e një sërë marrëveshesh të projektit, të cilat do të jenë pjesë e Dokumentacionit për ofertim. Ofertuesi i përzgjedhur do të jetë përgjegjës për dizajnimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e centralit solar FV, siç specifikohet në Dokumentacionin e ofertimit.

**5. Lloji i procedurës konkurruese:**

Procedurë e hapur e ofertimit konkurrues, sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2023 për Promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme.

**6. Lokacioni i projektit:**

Centrali solar FV do të ndërtohet në tokë publike, në zonën kadastrale të Kramovikut dhe Petkoviçit në Komunën e Rahovecit, e cila do t'i jepet me qira Ofertuesit të përzgjedhur për një periudhë jo më të shkurtër se 30 vjet.

**7. Afati për zbatimin e projektit:**

Ofertuesi i përzgjedhur, brenda 2 (dy) viteve nga data e nënshkrimit të Marrëveshjeve të projektit, do të komisionojë centralin solar FV në operim komercial.

**8. Marrëveshja për blerjen e energjisë:**

Ofertuesi i përzgjedhur do të realizojë një Marrëveshje për blerjen e energjisë (MBE) me Operatorin e Tregut për një periudhë pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, duke filluar nga data e komisionimit të centralit solar FV. MBE-ja do të konvertohet në Kontratë për Diferencë (CfD) me rastin e konfirmimit nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) se në Republikën e Kosovës është krijuar një treg likuid, funksional, i një dite para. Ofertuesi i përzgjedhur nuk do të ndikohet negativisht nga konvertimi i tillë, siç specifikohet në Marrëveshjet e projektit.

**9. Afati për dorëzimin e ofertave:**

15 gusht 2023, në ora 14.00 (CET).

**10. Data e hapjes së ofertave:**

18 gusht 2023, në ora 14.00 (CET).

**11. Periudha e vlefshmërisë së ofertës:**

Ofertat duhet të jenë të vlefshme për njëqind e pesëdhjetë (150) ditë, që nga data e përcaktuar si afati i fundit për dorëzimin e ofertave.

**12. Sigurimi i ofertës:**

Kërkohet sigurimi i ofertës, i lëshuar nga një bankë e klasës së parë, siç specifikohet në Dokumentacionin e ofertimit, në shumë prej 750,000 € (shtatëqind e pesëdhjetë mijë euro), i vlefshëm për një periudhë prej njëqind e tetëdhjetë ditësh (180), që nga dita e përcaktuar si afati i fundit për dorëzimin e ofertave.

**13. Procedura për qasje në Dokumentacionin e ofertimit:**

Dokumentacioni i ofertimit mund të merret pas kërkesës me shkrim drejtuar personit kontaktues në Ministrinë e Ekonomisë, duke filluar nga 16 maj 2023.

**14. Kërkesat për pranueshmëri dhe kriteret e dhënies:**

Ofertuesit e ardhshëm do të përmbushin kërkesat për pranueshmëri dhe kërkesat minimale për kualifikim të cilat u përkasin kërkesave teknike, profesionale, ekonomike dhe financiare. Kontrata do t'i jepet Ofertuesit të pranueshëm që ka ofruar çmimin më të ulët të garantuar të blerjes për MWh të energjisë së liferuar, i shprehur në EUR/MWh, duke përjashtuar TVSH-në. Detajet e tjera janë specifikuar në Dokumentacionin e ofertimit.

Informatat shtesë për Dokumentacionin e ofertimit mund të merren nga Personi kontaktues i Autoritetit kontraktues.